



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER DENISA ÇELA  
ADRESA NJESIA BASHKIAKE NR. 10,  
RR. RESHIT ÇOLLAKU, GODINA  
NR.7, APARTAMENTI NR.91, HYRJA  
NR.7  
TEL: 0694058103

## VËRTETIM NËNSHKRIMI

Nr. repertori: 1758

Tirane më 14/06/2024

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



V2024053750124981372



**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJESI TE KUFIZUAR  
“ULTIMATE WHEELS” SH.P. K**

Sot, më datë 14/06/2024 (dymije e njetete e kater), u paraqiten personalisht:

**THEMELUESIT:**

Mauricjo Rahmani, atësia Ferdinand, amësia Ermira, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Hoxha Tahsin; Nd. 179; H. 1; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1003; Tiranë, lindur më 12/05/1987, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 038777682 dhe nr. personal 170512057U;

Xhulio Angjellari, atësia Stojan, amësia Elida, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Perlat Rexhepi; Nd. 1; H. 6; Ap. 4; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 29/04/1995, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 038815039 dhe nr. personal J50429056B;

Palet kerkojne te themelojne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar bazuar ne Ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” si me poshte:

**TITULLI I  
EMRI I SHOQERISE - REGJIMI JURIDIK - SELIA – KOHEZGJATJA  
NENI 1**

**Emri i Shoqerise**

**1.1** Ne perputhje me legjislacionin shqiptar, eshte krijuar Shoqeria “ULTIMATE WHEELS” SH.P.K, ne vijim referuar si “Shoqeria”.

**1.2** Shoqeria ka logon dhe vulen e vet zyrtare.

**NENI 2**

**Regjimi Juridik i Shoqerise**

**2.1** “ULTIMATE WHEELS” SH.P. K , eshte nje Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar.

**2.2** Aktiviteti i saj eshte i organizuar sipas dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit dhe dispozitave ligjore ne fuqi mbi tregtine dhe legjislacionin civil ne Republiken e Shqiperise.

**2.3** Me vendim te Asamblese se Pergjithshme, Shoqeria mund te ndryshoje regjimin e saj juridik, ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi dhe dispozitat e Statutit te saj.

**2.4** Shoqeria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar.

**NENI 3**

**Selia**

**3.1** Shoqeria ka seline e saj ne adresen: **Njesia Bashkiake nr. 6, Rruga e Kavajes, Perballe ish Misto Mame, Zona Kadastrale nr.3866, numer pasurie 380/9, Tirane, Shqiperi.**

**3.2** Shoqeria mund te hape ose te mbylle dege, filiale dhe / ose zyra perfaqesimi brenda Shqiperise dhe / ose jashte vendit, ose te krijojë shoqeri te tjera me Partnere apo Aksionare pjesemarres.



**NENI 4  
Kohezigjatja**

**4.1** Kohezigjatja e veprimtarise se Shoqerise eshte e pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e Shoqerise ne Regjistrin Tregtar. Ortaku/et e Shoqerise mund te vendosin te kufizojne kohezigjatjen e aktivitetit me nje vendim te Asamblese se Pergjithshme.

**TITULLI II  
OBJEKTI  
NENI 5  
Objekti**

**5.1** Objekti kryesor i Shoqerise do te perfshije, por nuk do te kufizohet vetem ne veprimtarite e meposthme:

1. Tregetim disqe makina;
2. Tregetim pjese kembimi automjete;
3. Veprimtari te import, eksport e tregetim ne sektorin e vajrave lubrifikante me pakice;
4. Servis automjetesh dhe tregtim i pjeseve te automjeteve. Veprimtari sipermarrije industriale, transport mallrash dhe individesh;
5. Çdo aktivitet tjeter tregtar qe lidhet ne menyre te drejteperdrejte ose terthorazi me objektin e veprimtarise dhe qe eshte ne perputhje me legjislacionin ne fuqi;
6. Sipas legjislacionit ne fuqi, shoqeria ne menyre qe te arrije objektivat e saj mund te kryeje aktivitete te konsideruara te dobishme apo te nevojshme per te arritur qellimet e shoqerise;
7. Per me teper Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet tjeter i cili nuk eshte i ndaluar nga ligji ne fuqi, qe sjell perfitime dhe eshte ne interes te Shoqerise.

**TITULLI III  
KAPITALI I SHOQERISE - TRANSFERIMI I KUOTAVE- ZMADHIMI I KAPITALIT  
Neni 6**

**Kapitali i Shoqerise**

**6.1** Kapitali i shoqerise eshte ne vleren **100 LEK (njqind) i ndare ne 2 (dy) kuota.**

Kapitali i shoqerise eshte paguar plotesisht nga ortaket themelues si me poshte vijon:

a) Mauricjo Rahmani, nenshkruet i 1 (nje) kuote, qe perfaqeson 50 % te kapitalit te shoqerise, me nje vlere prej 50 Lek (pesedhjete leke),

b) Xhulio Angjellari, nenshkruet i 1 (nje) kuote, qe perfaqeson 50 % te kapitalit te shoqerise, me nje vlere prej 50 Lek (pesedhjete leke),

**6.2** Kontributi i ortakeve mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme apo te drejta)

**6.3** Pergjegjesia e Ortakeve ndaj paleve te treta per detyrimet e marra persiper nga kompania eshte e kufizuar sipas pjesemarrjes se tyre kapitalin e shoqerise.

**Neni 7  
Transferimi i kuotave**

**7.1** Transferimi i kuotave te shoqerise ndaj paleve te treta i nenshtrohet se drejtes se parablerjes ne favor te ortakeve te tjere te cilet mund ta ushtrojne kete te drejte sipas kushteve te percaktuara ne nenin

**7.2** deri ne nenin 7.6 me poshte.



7.2 Ne rast se nje ortak "Ofruesi" kerkon te shese dhe/ose te transferoje disa ose te gjitha kuotat e tij, Ortaket e mbetur do te kene te drejten e parablerjes ne lidhje me kuoten qe ofrohen per transferim ("Kuota e ofruar"), sipas kushteve te meposhtme:

(a) Ofruesi do tu dergoje fillimit ortakeve te mbetur nje njoftim me shkrim i cili percakton perqindjen e kuotes se ofruar, cmimin dhe kushtet e tjera te transferimit, duke ftuar se pari Ortaket e mbetur te blejne aksionet e ofruara;

(b) Ortaket mbetur do te kene te drejten te blejne kuotat e ofruara perpjestimisht dhe sipas kushteve te ofertes, duke i derguar nje njoftim me shkrim ofruesit brenda nje afati prej tridhjetete (30) ditesh pas marrjes se njoftimit te Ofuesit.

7.3 Ne rast se me shume se nje prej Ortakeve te mbetur deshirojne te blejne kuoten e ofruar, secili prej ketyre ortakeve te mbetur do te kete te drejten te bleje kuoten e ofruar perpjestimisht sipas perqindjeve qe zoterojne ne Shoqeri, duke i derguar nje njoftim me shkrim ofruesit brenda nje periudhe prej tridhjetete (30) ditesh nga marrja e njoftimit sipas se cilit secili prej tyre deshiron te bleje kuoten e ofruar.

7.4 Ne rast se asnje nga ortaket e mbetur nuk deshiron te bleje kuoten e ofruar dhe/ose kane refuzuar te blejne kuoten e ofruar dhe/ose nuk jane pergjigjur brenda tridhjetete diteve nga marrja e ketij njoftimi, Ofruesi do te kete te drejten ti transferoje Kuotat e ofruara nje pale te trete me te njetin cmim qe i eshte ofruar ortakeve te mbetur (sipas kushteve te ofertes fillestare). Nese ky kusht nuk eshte permbushur, Marreveshja per Shitjen e Kuotave me palet e treta do te jete e pavlefshme.

7.5 Ne rast se ndonje ose te gjitha ortaket e shoqerise blen/blejne kuotat e ofruara sipas kushteve te ofertes, sic percaktohet me siper, ky transferim do te kryhet sipas kushteve te ofertes.

7.6 Kushtet e parashikuara me siper nuk do te zbatohen ne rast transferimi te kuotave nga nje ortak tek nje shoqeri e cila ndodhet nen kontrollin e ketij ortaku ose ne rast transferimi nga nje ortak tek nje pasardhes ose pasardhes i drejperdrejte i tij ose tek bashkeshorti.

7.7 Dispozitat e neneve 7.1- 7.6, nuk do te zbatohen ne rast transferimi te bere ne favor te nje ose disa ortakeve te tjere. Megjithate, ne kete rast transferimi duhet ti komunikohet fillimisht te gjitha ortakeve. Te gjitha njoftimet sipas ketij neni duhet ti dergohen edhe Shoqerise.

#### Neni 8

##### Rritja e Kapitalit

8.1 Asambleja e Pergjithshme mund te rrise kapitalin e shoqerise, ne perputhje me kuorumin e percaktuar ne nenin 12 te ketij Akt Themelimi dhe Statuti.

8.2 Ne rast te nje rritje te kapitalit, ortaket kane te drejte te nenshkrimin te kuotave nepermjet kontributit ne natyre ose ne te holla, ne proporcion me perqindjen qe gezojne ne kapitali e shoqerise.

8.3 Nese ndonje nga ortaket refuzoje te drejten nenshkrimin, kapitali mund te nenshkruhet nga ortaket e tjeter. Ne kete rast, ortaket e tjere mund te ushtroje te drejten e tyre per nenshkrimin e kapitalit ne proporcion me perqindjen qe gezojne ne kapitalin e shoqerise.

#### Neni 9

##### Zvogelimi i Kapitalit

9.1 Asambleja e pergjithshme mund te zvogeloje kapitalin e shoqerise, ne perputhje me kuorumin e percaktuar ne nenin 12 te ketij Akt Themelimi dhe Statuti. Ne çdo rast, kapitali nuk mund te reduktohet nen vleren minimale te percaktuar me ligj.

9.2 Ortaket perballen me uljen e kapitalit te shoqerise ne proporcion me kuotat e zoteruara nga secili prej tyre ne kompani.

#### Neni 10

##### Certifikata e pjesemarrjes

10.1 Secili nga ortaket gezon te drejten nje certifikate ne lidhje me perqindjen ne pjesen qe gezon ne kapitalin e shoqerise. Shoqeria nuk eshte e detyruar te leshoje me shume se nje certifikate per kuotata e mbajtura se bashku nga disa Ortake dhe shperndarja e certifikates per perfaqesuesit e perbashket e anetareve do te konsiderohet e dhene ne interes te te gjitha ortakeve, ne perputhje me dispozitat e ligjit.



STERI  
PIRANE

**TITULLI IV**  
**ORGANET E SHOQERISE**  
**Neni 11**  
**Organet e Shoqerise**

11.1 Organet e Shoqerise jane:

- 1) Asambleja e Pergjithshme;
- 2) Administratori / s.

**ASAMBLEJA E PERGJITHSHME**

**Asambleja e Pergjithshme**

11.1 Asambleja e Pergjithshme eshte organi vendimmarres i Shoqerise dhe perbehet nga te gjithë Ortaket e Shoqerise.

11.2 Çdo Ortak ka te drejte te marre pjese ne Asamblene e Pergjithshme per te shprehur mendimin e tij dhe te votoje ne baze te kuotave qe zoteron.

11.3 Ortaku mund te perfaqesohet nga nje person tjetër, jo domosdoshmerisht Ortak/e, me ane te nje Prokure te Posacme. Ne çdo rast, kjo Prokure e Posacme mund te jepet vetem per nje Mbledhje te caktuar te Asamblese se Pergjithshme, dhe do te jete e vlefshme edhe per mbledhjet pasardhese me te njejtin rend dite. Administratorët nuk mund te perfaqesojne Ortakun ne mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme.

11.4 Asambleja e Pergjithshme mund te mblidhet ne nje vend te ndryshem nga selia e Shoqerise, ne Republiken e Shqiperise ose jashte vendit.

11.5 Asambleja e Pergjithshme thirret nga Administratori, sipas nevojave dhe interesave te Shoqerise ose nese kerkohej nga legjislacioni ne fuqi. Asambleja e Pergjithshme mund te thirret edhe nga cdo Ortak qe zoteron te pakten 10% (dhjete per qind) te pjeses se kapitalit. Ne çdo rast, Asambleja e Pergjithshme mblidhet te pakten nje here ne vit, brenda javes se fundit te muajit Maj, ne menyre qe te diskutoje, te shqyrtoje dhe te miratoje bilancin vjetor te vitit te kaluar fiskal. Mbledhja e pare e Asamblese se Pergjithshme, do te mbahet brenda tre muajve nga dita e regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregtar per te diskutuar planin e biznesit dhe çeshtje te tjera.

11.6 Njoftimi per mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme do te behet me leter rekomande me njoftim marrjeje, dhe do te dergohet ne adresat e Ortakeve te shoqerise te regjistruara ne Regjistrin e Ortakeve, ose me poste elektronike ne adresat e Ortakeve, ose me poste tek Ortaket se paku 21 (njetzet e nje) dite perpara dates se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme.

11.7 Njoftimi duhet te permbaje informacion mbi ceshtjet qe do te diskutohen ne rendin e dites dhe mbi te cilat do te merret vendim, vendin, oren dhe daten e thirrjes se pare dhe te dyte, si edhe procedurat e detajuara te pjesemarrjes dhe te votimit, informacion mbi vendin dhe menyra e marrjes se dokumentacionit dhe projekt vendimeve te asamblese si edhe elementet e tjera te percaktuar nga legjislacioni ne fuqi.

11.8 Asambleja e Pergjithshme do te konsiderohet e mbledhur rregullisht edhe nese nuk ka ndjekur te gjitha formalitetet e thirrjes, nese te gjithë Ortaket qe perfaqesojne pjesen e tere kapitalit te shoqerise jane te pranishem ne mbledhje apo te perfaqesuar nga nje perfaqesues me prokure te posacme, dhe shprehen dakort per te zhvilluar mbledhjen e asamblese pavaresisht parregullive ne thirrjen e saj.

11.9 Asambleja e Pergjithshme mund te mbahet edhe me pjesemarrjen e njerezve ne vende te ndryshme, dhe mund te mbahet permes telekonferences apo videokonferences, ose mjete te tjera te ngjashme elektronike, me kusht qe te gjithë pjesemarrësit te mund te identifikohen dhe t'i jepet mundesia per te marre pjese ne diskutimet dhe per te marre pjese ne to.

11.10 Asambleja e Pergjithshme kryesohet nga Kryetari i cili emerohet nga radhet e Ortakeve te pranishem ose te perfaqesuar ne mbledhje. Nese prezenca e nje noteri publik nuk eshte e nevojshme, Asambleja e Pergjithshme do te emeroje nje sekretar, i cili nuk duhet te jete domosdoshmerisht nje nga Ortaket.

11.11 Kryetari i Mbledhjes ka kompetenca te plota per te kontrolluar prokurat e posacme dhe rregullsine e tyre, te drejten e Ortakeve dhe perfaqesuesve te tyre per te marre pjese ne Asamblene e



Pergjithshme, si dhe per te percaktuar nese Mbledhja eshte thirrur rregullisht dhe nese kuorumi i nevojshem per marrjen e Vendimeve te vlefshme eshte arritur. Kryetari ka gjithashtu te drejten per te drejtuar diskutimet dhe per te percaktuar metodat dhe procedurat e votimit.

11.12 Ne rast se Shoqeria ka vetem nje Ortak qe ka fituar Kuotat e Ortakeve te tjere me ane te nje procesi ligjor dhe zoteron tere kapitalin e shoqerise, vendimet e Ortakut te vetem do te regjistrohen ne regjistrin e vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose fshihen.

## NENI 12

### Kuorumi dhe Kompetencat e Asamblese se Pergjithshme

12.1 Ne rast vendimesh te zakonshme, Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese jane te pranishem ortaket e shoqerise qe zoterojne me shume se 50% (pesedhete perqind) te Kuotave me te drejte vote. Nese Asambleja e Pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumi ne thirrjen e pare, asambleja mund te mblidhet perseri me te njejtin rend dite brenda dhe jo me vone se 30 (tridhete) dite pas thirrjes se pare. Vendimet e zakonshme merren me voten pro te shumices se ortakeve te pranishem apo te perfaqesuar.

12.2 Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te zakonshme mbi ceshtjet e meposhtme:

- (a) percaktimin e politikave tregtare;
- (b) emerimin dhe shkarkimin e Administratorit;
- (c) emerimin dhe shkarkimin e eksperteve kontabel te autorizuar dhe likuiduesve;
- (d) miratimin e shperblimeve per personat e permendur ne paragrafet (b) dhe (c);
- (e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- (f) monitormin dhe mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga Administratori;
- (g) perfaqesimin e Shoqerise ne gjykate dhe ne proceset gjyqesore ndaj Administratorit;
- (h) cdo ceshtje tjeter te percaktuar nga ligji apo statuti.

12.3 Ne rast vendimesh te jashtezakonshme, Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese jane te pranishem ortaket qe zoterojne me shume se 50% (pesedhete perqind) te kuotave me te drejte vote. Nese Asambleja e Pergjithshme nuk mund te mblidhet perseri me te njejtin rend dite brenda dhe jo me vone se 30 (tridhete) dite pas thirrjes se pare. Vendimet e jashtezakonshme merren me voten pro te te pakten  $\frac{3}{4}$  (tre te katertat) e ortakeve te pranishem apo te perfaqesuar.

12.4 Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te jashtezakonshme mbi ceshtjet e meposhtme:

- (a) ndryshimi apo plotesimi i Statutit te Shoqerise;
- (b) zmadhimi apo zvogelimi i kapitalit
- (c) shperndarjen e fitimeve vjetore nepermjet dividenteve dhe akordimin e aksioneve ne vend te dividenteve;
- (d) riorganizimin, shperndarjen, transformimin, bashkimin, shkrirjen, ndarjen, likujdimin apo prishjen e shoqerise si edhe riorganizimin e shoqerise ne nje forme tjeter;
- (e) ndermarrjen e cdo veprimi i cili pitet ne menyre te arsyeshme se do te coje ne likujdimin e shoqerise;
- (f) hapjen e nje dege, blerjen apo shitjen e nje dege me ose pa emer;
- (g) marrjen persiper te cdo detyrimi me nje vlere me te larte se 5% (pese perqind) te aktiveve totale te shoqerise sic rezulton nga pasqyrat e fundit financiare te audituara.

## NENI 13

### Administratori

13.1 Asambleja e Pergjithshme do te caktojte nje (1) personi fizik si Administrator te shoqerise, i cili mund te jete ortak ose jo dhe qe do te jete pergjegjes per ceshtjet e perditshme te Shoqerise sipas kufizimeve te parashikuara nga ligji ne fuqi dhe me kete Statut.

Administratori ushtron keto detyra:

- (a) menaxhon shoqerine duke zbatuar politikat sic percaktohet nga Asambleja e Pergjithshme;
- (b) sigurohet qe te mbahen librat dhe dokumentet e nevojshme kontabel;

(c) Mban dhe nenshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise dhe ja paraqet ate Asamblese se Pergjithshme per miratim se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve;

(d) krijon nje sistem paralajmerimi te hershem ne lidhje me zhvillimet qe kercenojne ekzistencen e shoqerise;

(e) paraqet te dhenat e shoqerise per t'u regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit, sipas rastit;

(f) raporton perpara Asamblese se Pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe per realizimin e veprimeve me rendesi te vecante per punen e Shoqerise;

(g) cdo detyre tjeter siç percaktohet me ligj ose Statut.

13.2 Administratori emerohet per nje periudhe deri ne 5 (pese) vite dhe me te drejte rizgjedhjeje. Ky emerim prodhon efekte ligjore ne daten e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

13.3 Shoqeria merr angazhime me nenshkrimin e vetem te administratorit, sipas kufizimeve te parashikuara nga ligji ne fuqi dhe ne kete Statut dhe Akt Themelimi.

13.4 Administratori i shoqerise ka te drejten dhe detyrimin per te perfaqesuar Shoqerine ne marredheniet me te tretet.

13.5 Asambleja e Pergjithshme emerohet si Administrator te shoqerise, Mauricjo Rahmani, atësia Ferdinand, amësia Ermira, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Hoxha Tahsin; Nd. 179; H. 1; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1003; Tiranë, lindur më 12/05/1987, per nje afat 5 (pese) vjecar me te drejte rizgjedhjeje.

## TITULLI V VITI FINANCIAR, DIVIDENTI NENI 14

### Viti Financiar

14.1 Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti.

14.2 Perjashtimisht viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit ne QKB (Qendra Kombetare e Biznesit) dhe perfundon me 31 Dhjetor te atij viti.

## NENI 15

### Dividentet dhe Kapitalizimi i Fitimeve

15.1 Permes vendimit te asamblese se pergjithshme shoqeria shperndan dividendin ne perputhje me te drejtat perkatese te ortakeve, nese:

a) aktivet e shoqerise mbulojne teresisht detyrimin e saj;

b) shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te paguar detyrimet qe duhet te jene te pagueshme brenda 12 muajsh.

15.2 Kapitalizimi i Fitimeve. Me vendim te Asamblese se Pergjithshme dhe ne lidhje me parimet e percaktuara ne nenin 14, te Ligjit 9901, date 14.04.2008 i ndryshuar, Ligj nr. 129/2014, administratori mund te vendose per te kapitalizuar fitimet.

## TITULLI VI SHPERBERJA-NDARJA-BASHKIMI- LIKUIDIMI NENI 16

### Prishja-Ndarja-Bashkimi

16.1 Shoqeria mund te prishet per shkaqet e parashikuara me ligj. Ne rast te prishjes, Asambleja e Zakonshme e Ortakeve emerohet nje ose me shume likuidatore duke u percaktuar kompetencat reciproke.

16.2 Shoqeria gjithashtu mund te ndahet ose te bashkohet me ane te nje vendimi te asamblese se jashtezakonshme te ortakeve.

## NENI 17





### Likuidimi

17.1 Ne rast te prishjes shoqeria mund te likuidohet.

17.2 Per te administruar kete procedure, Asambleja e Zakonshme e Ortakeve emeron nje ose me shume likuidatore i cili do te hartoje raportin perfundimtar mbi aktivet dhe pasivet e shoqerise, si dhe procedurat dhe kohen e duhur per likuidim.

17.3 Ne fund te procedurave te likuidimit, Asambleja e Zakonshme e Ortakeve do te vendose ne lidhje me bilancin perfundimtar, punen e bere nga likuiduesi dhe te perfundoje procesin e likuidimit.

17.4 Me likuidimin e kreditoreve likuiduesit gjithashtu do te shperndajne aktivet e mbetura te Ortakeve ne proporcion me perqindjen qe ata disponojne.

### TITULLI VII TE NDRYSHME NENI 18

#### Gjuha dhe Zgjidhja e Mosmarveshjeve

Çdo mosmarveshje ose mosmarveshjet ndermjet ortakeve ose ne mes tyre ne Shoqeri fillimisht do te zgjidhet ne menyre te brendshme dhe miqesisht. Nese, nje zgjidhje miqesore nuk mund te arrihet brenda 60 ditesh, çështja do t'i referohet Gjykatave te Tiranës, me nje proces te rregullt qe do te zhvillohet ne Tiranë, Shqiperi.

#### DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Për sa më sipër, u hartua Akti i Themelimit dhe Statuti i Shoqërisë me Përgjegjesi te Kufizuar **“ULTIMATE WHEELS” SH.P.K.** në prezencë të ortakeve të shoqërisë, bazuar në vullnetin e lirë e të plotë të tyre, si dhe në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare. Pasi u lexua qartazi dhe u kuptua rëndësia dhe efektet ligjore, nënshkruhet Akti i Themelimit dhe Statuti i Shoqërisë me Përgjegjesi te Kufizuar **“ULTIMATE WHEELS” SH.P.K** me adrese ne **Njesia Bashkiake nr. 6, Rruga e Kavajes, Perballe ish Misto Mame, Zona Kadastrale nr.3866,numer pasurie 380/9, Tirane, Shqiperi** dhe Administrator Z. Mauricjo Rahmani.

Per sa me siper autorizohet nga ana e Ortakeve dhe Administratori Denisa Çela, me qellim aplikimin per regjistrimin e Shoqerise **“ULTIMATE WHEELS” SH.P.K.**, prane Qendres Kombetare te Biznesit, me te drejta te plota per te nenshkruar elektronikisht formularin e aplikimit per regjistrim fillestar.

Akti i Themelimit dhe Statuti i Shoqërisë me Përgjegjesi te **“ULTIMATE WHEELS” SH.P.K.** u hartua ne gjuhen shqipe, në 3 (tri) kopje origjinale me fuqi të njëjtë juridike i përbërë nga 7 (shtate) faqe.

#### ORTAKËT THEMELUES

Z. Mauricjo Rahmani

Mauricjo Rahmani



Z. Xhulio Angjellari

Xhulio Angjellari





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER DENISA ÇELA



DATE 14/06/2024  
NR REP 1758

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 14.06.2024 (dymije e njezete e kater), para meje Notere DENISA ÇELA, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NJESIA BASHKIAKE NR. 10, RR. RESHIT ÇOLLAKU, GODINA NR.7, APARTAMENTI NR.91, HYRJA NR.7, u paraqiten personalisht:

NËNSHKRUESIT:

Mauricjo Rahmani, atësia Ferdinand, amësia Ermira, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Hoxha Tahsin; Nd. 179; H. 1; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1003; Tiranë, lindur më 12/05/1987, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 038777682 dhe nr. personal I70512057U.

Xhulio Angjellari, atësia Stojan, amësia Elida, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Perlat Rexhepi; Nd. 1; H. 6; Ap. 4; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 29/04/1995, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 038815039 dhe nr. personal J50429056B.

Personat e mësipërm, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, "*Akti i Themelimit dhe Statuti i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "Ultimate Wheels" shpk, date 14.06.2024*", bashkëlidhur.

Unë Noterja, pasi verifikova identitetin e personit të sipërcituar, nëpërmjet mjetit të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenin 128 të ligjit nr. 110/2018 "*Për Noterinë*", dhe Udhëzimit nr. 23, datë 7.12.2020 "*Për evidentimin, administrimin, ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale dhe për organizimin, funksionimin dhe ruajtjen e arkivave noterialë, përfshirë formatin e tyre, si dhe formën, përmbajtjen, verifikimin e rregullueshmërisë dhe administrimin e regjistrave të veprimtarisë noteriale*", vërtetoj nënshkrimin e tij.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave Personale*", i ndryshuar unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTERE

DENISA ÇELA